

ALBANA DEDA (NDOJA)

TOGFJALËSHI, SINTAGMA DHE TRAJTIME TË TYRE NË GRAMATOLOGJINË SHQIPTARE

Studimet tona tradicionale në lëmin e sintaksës së shqipes kanë njohur trajtime të ndryshme, të bëra nga studiues të njohur, të cilët hodhën bazat e përshkrimit të strukturës sintaksore të kodit tonë. Ndër to spikasin punimet e gjuhëtarit Spiro Floqi kushtuar aspekteve të ndryshme të strukturës së shqipes, veçanërisht atyre të sintaksës së periudhës.

Pavarësisht pohimit të mësipërm, mund të themi pa droje se gjuhëtarit Spiro Floqi është kodifikuesi i konceptit tradicional të teorisë së togfjalëshit, pasqyruar edhe në veprën “Gramatika e gjuhës shqipe” II, Tiranë, 2002. Pikëpamjet e tij mbi këtë teori autori i i parashtrroi së pari në punimin “Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme”, të botuar në 1968 në Studime Filologjike, nr. 1. Ky artikull shquhet jo vetëm për forcën e argumentit shkencor, por dhe për jetëgjatësinë e mendimit të tij shkencor (Tradita e studimeve tona na shfaq trajtime të cilat, për hir të së vërtetës, na japin pak alternativa dhe zakonisht janë në rrafshin tradicional, sidomos para viteve 90¹).

Në këtë punim ai thekson domosdoshmërinë e strukturimit të mëtejshëm të fjalisë drejt mikrostrukturës së saj. Prof. Floqi vëren se “Teoria e fjalisë dhe e gjymtyrëve të saj nuk mund të zbulojë atë varg lidhjesh sintaksore të gjalla midis fjalëve në fjali, rregullitë e lidhjes së fjalëve në fjali dhe të bashkimit të fjalëve në njësi më të mëdha, të afta për të funksionuar edhe si gjymtyrë fjalie, të cilat janë lënë në heshtje në sintaksat e shqipes (ashtu si në sintaksat e shumë gjuhëve të mëdha ose jo)”².

Për këtë arsye togfjalëshi shihet prej tij, si një njësi e ndërmjetme mes fjalisë dhe fjalës. Ai perceptohet përgjithësisht si element ndërtues i strukturës së fjalisë (objektit kryesor të studimit sintaksor)³. Citojmë “...fjalë kur është e zbërthyeshme, e analizueshme, është sajuar prej fjalësh të bashkuara nga

¹ R. Përnaska, *Diskutim për kumtesën e Spiro Floqit*, Revista pedagogjike, 1972, nr. 5; J. Lukaj, *Togfjalëshi*, Buletin shkencor, Shkodër, 1972, nr. 2; H. Agani, *Fjala*, Prishtinë, 1975, si dhe qëndrime të mbajtura në tekste shkollore parauniversitare, si ato të Totonit, Bobratit, Dakos, *Gjuha shqipe* 7, 1971 etj.

² S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, 1968/1, f. 75.

³ S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, 1968/1, f. 75.

pikëpamja gramatikore dhe kuptimore në njësi të caktuara sintaksore, në togfjalëshe”⁴.

Artikulli strukturohet në dy drejtime: I pari synon të sqarojë çështjen e natyrës së togfjalëshit duke analizuar “vëllimin e përbërjen e tij, llojin e natyrës sintaksore që e sajton dhe vlerën e tij”. Pjesa e dytë merret me raportet që ekzistojnë mes togfjalëshit dhe njësive të tjera si fjala, fjalia dhe gjymtyrët e kësaj të fundit.

Prof. Floqi përcakton masën minimale të togfjalëshit. Sipas tij, kjo e fundit përbëhet prej dy elementesh, por jo të çfarëdoshëm, përkatësisht prej dy fjalësh shënjuese⁵. Një strukturë e tillë formon togfjalëshin e thjeshtë. Ky ndërtim ka në bazë nënrenditjen, në të cilën njëra gjymtyrë e togfjalëshit është gramatikisht kryesore dhe tjetra e varur. Në lidhje me masën maksimale të togfjalëshit, ai nuk përcakton limite të prera, por pranon faktin se më së shumti ai mund të ketë dy, tri dhe më rrallë më shumë elemente të varura.

Mundësinë e shprehjes së një togfjalëshi me një fjalë, autori e sheh si një konceptim çoroditës dhe formalist njëkohësisht, pasi një njësi e vetme “...nga vlera e saj nuk e zbulon dot, vetëm ajo, funksionin e saj sintaksor.” Sipas nesh, analiza e mësipërme nuk merr parasysh elipsën kontekstuale, marrëdhëniet mes togfjalëshave, si dhe konceptin e domosdoshmërisë, apo obsionalitetit të njësive përbërëse të togfjalëshit etj.

Floqi përcakton këto modele “lidhjesh”⁶: fjalë + fjalë, fjalë + togfjalësh dhe togfjalësh + togfjalësh. Modelet e parashikuara prej tij gjithashtu përjashtojnë mundësinë e ekzistencës së një fjale të veçantë si togfjalësh, apo marrëdhënien e një fjale, togfjalëshi tjetër me një fjali, si njësia kryesore e sintaksës tradicionale. Secila prej lidhjeve ilustron me shembuj (Gjatë analizave të pjesëve përbërëse të togfjalëshit, në ndonjë rast është dhënë dhe ndonjë shembull i dyshimtë. P.sh. kur flitet për marrëdhëniet fjalë + togfjalësh jepen dhe këta tre shembuj: *nxënësin e shkathët*, *nxënësin e saj të shkathët*, *nxënësin shumë të shkathët*. Këto grupime janë dhënë për të ilustruar dhe përdorimin e nyjës së mbiemrit *e* ose *të*, kur në mes futet një njësi tjetër, dhe për të argumentuar faktin se kemi të bëjmë jo me bashkërenditje të përcaktorëve, por me nënrenditje, prandaj dhe “*të shkathët*”, nuk lidhet direkt me njësinë drejtuese, nuk varet më direkt nga ajo, por nga togfjalëshi i formuar. Sipas nesh, grupi i fundit nuk është i njëjti me dy të parët ose më saktë nuk ekziston një varësi direkte mes *nxënësin* dhe *shumë të shkathët* në togfjalëshin emëror, vetëm nëse kemi një folje drejtuese. Kemi parasysh se ai dallon togfjalëshat emërorë, mbiemërorë, foljorë, ndajfoljorë dhe përemërorë.).

⁴ Po aty, f. 75.

⁵ Po aty, f. 76.

⁶ Kjo është terminologjia e përdorur nga Floqi.

“Si pjesë të togfjalëshit konceptohen gjithashtu fjalët shërbyese të tilla si “nyjat, parafjalët etj”. Floqi nuk konsideron togfjalësha “të ashtuquajturit togfjalësha me bashkërenditje”, sepse vetitë e tyre zbulohen në teorinë e gjymtyrëve të fjalisë, te gjymtyrët homogjene⁷”. Në këtë kontekst vetëm marrëdhëniet e nënrenditjes, janë ato që merren parasysh në këto grupime.

Në Gramatikën II⁸ koncepti i shprehur në lidhje me togfjalëshin është pothuajse i njëjtë me trajtimin e dhënë nga prof. Floqi. Në këtë vepër ky koncept përcaktohet si “...njësia sintaksore strukturore e përftuar gjatë ligjërimit nga bashkimi gramatikor dhe kuptimor i dy ose me shumë fjalëve kuptimplota të bashkuara me lidhjen e nënrenditjes, që tregon marrëdhënie midis sendeve, dukurive, proceseve e tipareve”.

Në këtë vepër, emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët, foljet, ndajfoljet shihen si njësitë që mund të formojnë togfjalësha, ndërsa fjalët shërbyese janë krahas formave të fjalëve, mjete për bashkimin e fjalëve kuptimplota në togfjalësha (aty përcaktohen si të tilla parafjalët, lidhëzat). Në ndryshim nga trajtimi i Floqit, Gramatika II sheh si togfjalësh dhe togfjalëshat numërorë. Ndërkohë në dy trajtimet lihen jashtë grupimet parafjalore, të cilat shihen si pjesë përbërëse e togfjalëshit, por jo si njësi drejtuese. Fjalja nuk bën pjesë në përbërjen e togfjalëshit sipas të dy trajtimeve. Gjithashtu në Gramatikën akademike nuk pranohet togfjalëshi predikativ, megjithëse pohohet se disa studiues e njohin këtë strukturë si togfjalësh (Në Gramatikën II gjejmë këtë pohim: “Nga shumica e studiuesve pranohen vetëm togjet me raporte nënrenditëse, duke përjashtuar bashkimet me raporte bashkërenditëse, shpesh dhe bashkimet kallëzuesore kryefjalë-kallëzues, të karakterizuara me raporte të veçanta ndërvarësie të ndërsjellë. Ka studiues që bashkimet kallëzuesore nuk i veçojnë nga togfjalëshat, po këta, sipas raporteve që shprehen i ndajnë në togfjalësha predikativë (kallëzuesorë) dhe në togfjalësha jopredikativë”⁹).

Mungesa e togfjalëshit predikativ në trajtimin e Gramatikës II e cungoi, sipas nesh, një pjesë të lidhjeve të natyrshme që krijon një njësi e tillë drejtuese si folja. Nga ana tjetër, pranimi i togfjalëshit predikativ nga Floqi përbën një konceptim më të gjerë, nëse u referohemi lidhjeve dhe marrëdhënieve të brendshme të njësisë drejtuese me njësinë e varur, në kuadrin e një njësie drejtuese si folja dhe e një të varure si kryefjala, që tradicionalisht përbëjnë gjymtyrët kryesore të fjalisë tradicionale.

Sipas Floqit, togfjalëshi predikativ mund të përbëjë bërthamën leksikogramatikore të një fjalie (Floqi:80), megjithatë ai përsëri nuk mund të përfaqësojë komplet fjalinë. Ai pohon se kjo lloj marrëdhënieje mbështetet më

⁷ Gramatika e gjuhës shqipe II, f. 77.

⁸ Gramatika e gjuhës shqipe II, f. 82.

⁹ Gramatika II, f. 80.

shumë në lidhjen predikative, pasi për të qenë fjali ky togfjalësh duhet të plotësohet nga tipare të tjera si: intonacioni, karakteri relativisht i plotë komunikativ, qëllimi i thënies, rendi i fjalëve, të gjymtyrëve të fjalisë të shoqëruar nga elementi intonacionor i theksimit.

Koncepti, sipas të cilit, togfjalëshit predikativ i mungon “karakteri i plotë komunikativ”, sipas nesh, i jep një rol periferik kësaj strukture në perspektivën komunikuese, në të cilën një ndërtim i tillë realizon komunikim dhe nuk krijon zhurmë në kanalin e komunikimit. Edhe mungesa e një intonacioni dhe e një qëllimi thënieje, bie poshtë nga vetë shembujt e tij. Ai thekson se struktura “Erdhi treni.” mund të dalë me tre fjali të ndryshme (për nga intonacioni dhe qëllimi i thënies): si dëftore, si pyetje dhe si thirrmore. Pra këtu nuk shtrohet çështja se thënia nuk ka intonacion dhe qëllim, por e kundërta, intonacioni dhe qëllimi jo vetëm që janë të pranishëm, por dalin në tre variante.

Rendi i përcaktuar i fjalëve është një kriter i nevojshëm, sipas Floqit, në mënyrë që një strukturë specifike të quhet fjali. Për këtë arsye togfjalëshi predikativ nuk mund të jetë fjali pohon ai. Duhet thënë se, pavarësisht se e përmend si kriter të përcaktimit të fjalisë rendin e fjalëve, ai nuk jep ndonjë argument bindës në lidhje me të. Diskutimin për rendin e fjalëve, ai e realizon më shumë në kuadrin e “së njohurës” dhe “të panjohurës”. Në varësi të ndryshimit të vendit të këtyre të fundit, herë te kryefjala dhe, herë të kallëzuesi, ato japin dhe kuptime të ndryshme, që jepen nga fjali të ndryshme¹⁰. Pra në të vërtetë nuk i referohet direkt konceptit të rendit të fjalëve në kuptimin tradicional.

Një element tjetër që e hasim te Floqi dhe Gramatika II është dhe fjala shërbyese. Fjalët shërbyese janë njësi, të cilat shihen si elemente ndihmëse dhe nuk zënë vend kryesor si në trajtimin e Floqit, ashtu dhe në Gramatikën II. Ato përmenden mjaft shkurt dhe pa dhënë kriteret e qarta dalluese. Të bën përshtypje fakti se në artikullin e Floqit, kur flitet për to, si të tilla përmenden nyjat dhe parafjalët, ndërsa te Gramatika II, ky funksion u atribuohet parafjalëve dhe lidhëzave (si mjete lidhëse të pjesëve përbërëse të togfjalëshit). Duhet thënë se në asnjë rast lidhëzat nuk shfaqen në togfjalëshat ilustrues te ky i fundit. (Natyrisht që ka një logjikë në këtë kontekst, prania e tyre do të

¹⁰“Veç kësaj, me po atë togfjalësh predikativ, në sajë të kombinimit të rendit të fjalëve me theksimin e gjymtyrëve mund të kemi dhe një varg fjalësh të tjera që ndryshojnë nga ngarkesa komunikative e gjymtyrëve të lidhur me “të dhënë” dhe me “të renë”, ne do të thoshim me “të njohurën” dhe “të panjohurën”. Kështu pra, në togfjalëshin predikativ, fjalët shqyrtohen në nivelin e togzueshmërisë së fjalëve në togfjalësh, ndërsa në fjali fjalët dhe togfjalëshat diskutohen në nivelin e gjymtyrëve të fjalisë.” S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit*, SF, 1968/1, f. 81.

kategorizonte dhe një pjesë fjalish, sidomos ato të nënrenditurat, si pjesë të togfjalëshit.).

Gjithashtu vihet re se përciptazi përmendet koncepti i fjalës përcaktuese si në Gramatikë, ashtu dhe te Floqi. Ato konceptohen si fjalë që nuk ekzistojnë vetëm si gjymtyrë fjalie, po i bashkëngjiten një emri për të funksionuar së bashku me të si një gjymtyrë e vetme e fjalisë. (“Në disa raste emri mund të jetë i vetëm në trajtë të pashquar, në raste të tjera ai nuk është i vetëm, po në trajtë të pashquar, sepse shoqërohet nga *përemri i pacaktuar* një, përemrat dëftorë, përemrat pyetës, përemrat e pacaktuar etj, të cilët së bashku me përemrin e pacaktuar *një* mund të emërtohen me termin e përbashkët fjalë përcaktuese ose caktuesorë (determinativ)”¹¹). Te Floqi më shumë ky koncept është përdorur për të shpjeguar rastet, kur emri nuk mund të funksionojë vetë si kryefjalë, por ai nuk ka folur për këtë element te togfjalëshat e tjerë, veç togfjalëshit emëror. Nga shembujt e marrë prej tij, si të tillë dalin në një pjesë modelesh nyja e pashquarsisë *një*, përemrat dëftorë, përemrat e pacaktuar, në ndonjë rast dhe ndonjë përemër pyetës (një dallëndyshe, ajo këshillë, çdo aksionist, sa veta, disa gra, shumë partizanë)¹².

Nga parashtrimi i mësipërm mund të shihet konceptimi përgjithësisht i njëjtë i trajtimit të Floqit me atë të Gramatikës II. Togfjalëshi konceptohet si njësi ndërtuese, por jo komunikuese. Trajtimet na japin modele jo të plota të shfaqjes së tyre në strukturën e shqipes. Vëllimi i tij natyrisht paraqitet mungesor në dy kahet e tij (përkatësisht nuk pranohet ekzistenca e togfjalëshit të përfaqësuar vetëm nga një njësi, ashtu si dhe nuk pranohet fjalia si një element i tillë). Nuk ka kriteret e qarta në lidhje me rrafshet e ndryshme gjuhësore si në pranimin (nga Floqi) apo mospranimin (nga Gramatika) të togfjalëshit predikativ dhe faktit se përse ai nuk mund të përbëjë fjalinë (Floqi). Ka probleme dhe në pasqyrimin e saktë të elementeve të brendshme të togfjalëshit, si të fjalëve shërbyese, ashtu dhe të fjalës përcaktuese. Natyrisht dhe numri i grupimeve që u përcaktuan si togfjalësha, ishte i kufizuar dhe u lanë jashtë klasa të tilla si parafjalët apo dhe lidhëzat dhe grupimet që përcaktoheshin nga këto të fundit (fjalitë). Trajtimi i togfjalëshit foljor gjithashtu shfaqet mjaft problematik, pasi së pari ai shihet si gjithë togfjalëshat e tjerë, duke mos i dhënë vendin kryesor në hierarkinë e brendshme të fjalisë. Së dyti, jo të gjitha njësitë që realisht varen nga folja, u pasqyruan në ndarjet e dhëna nga Floqi.

Gjithsesi, konceptimet e S. Floqit kanë qenë shtylla kryesore, në të cilën më pas janë mbështetur hartuesit e teksteve universitare dhe parauniversitare, të paktën deri në fillimet e viteve 90-të dhe në krahasim me

¹¹ Gramatika II, f. 80.


¹² S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit*, SF, 1968/1, f. 78.

traditën pararendëse ato përbëjnë një përpjekje më serioze në këtë fushë studimi.

Pas viteve '90 rënia në kontakt me teorinë e ndaluara gjuhësore deri në atë kohë, solli dhe konceptime të reja në lidhje me grupet e fjalëve, që deri atëherë ishin parë në kuadrin e togfjalëshit. Tashmë këto të fundit u diskutuan në kontekstin e teorisë së sintagmës. Një gjë e tillë u shfaq në punimet e Memushajt, Buxhelit, Mitës, Turanos, Kolecit, Dhimës, Kallullit, Kapiajt, Kananajt etj (Në të vërtetë jo të gjithë këta studiues përdorin termin “sintagmë”, pavarësisht se i referohen të njëjtit drejtim. Ka pasur studiues të cilët kanë përdorur termin “frazë” në vend “të sintagmës”). Këta janë studiues që përgjithësisht dhanë trajtime brenda kuadrit të Gramatikës gjenerative. Në këto studime flitet për termin sintagmë (e cila në gjuhësinë shqiptare njihet si term dhe para 90-ës, pasi e përdor dhe Floqi e Kostallari). Natyrisht që koncepti i fundit paraqet mjaft ndryshime në krahasim me teorinë e togfjalëshit, të paraqitur më sipër dhe përbën një teori tërësisht të dallueshme nga ajo.

Sipas Rami Memushajt “Sintagma është një njësi me madhësi të papërcaktuar, si sintagmë mund të shërbejë një fjalë e vetme ose një fjali e tërë e varur. Pra sintagma është më fort një njësi pune e sintaksës gjenerative. Ajo nuk duhet ngatërruar me togfjalëshin tradicional, i cili nuk është gjë tjetër veçse një sintagmë që ka dy përbërës, njëri kryesor dhe tjetri i varur prej tij, por të dy kategori leksikore.”¹³. Memushaj dallon sintagmat emërore, mbiemërore, foljore, parafjalore dhe ndajfoljore dhe shton se gjenerativistët nuk e njohin këtë të fundit në grupin e sintagmave, por si pjesë të strukturës së SMB- sintagmat mbiemërore.

Në punimin e Josif Mitës “Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe¹⁴” jepet skema e sintagmave të ndryshme me koka leksikore të shqipes që i përshtaten këtij diagrami pemë:



¹³ R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, shblu, Tiranë, 2008, f. 109.

¹⁴ J. Mita, *Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe*, Studime albanologjike, Tiranë, 2000, f. 27-41.

Ne po u referohemi punimeve të autorëve tanë, pavarësisht se skemat nuk janë të tyre, për të thënë se çfarë është bërë në kuadrin e analizës së korpusit të shqipes.

Nga skema vihen re hierarkitë e vendosura mes kokave të ndryshme të sintagmave leksikore dhe pozicioni i lartë dominues që ka specifikatori (specifikuesi nga pjesa më e madhe e studiuësve). Nyjat përbërëse lidhen mes tyre me rregullave rishkruese, të cilat realizojnë dhe projeksionet specifike, sipas veçorive të sintagmave të ndryshme.

Në këtë punim flitet për katër lloje sintagmash (SE, SF, SMB, SP) duke lënë jashtë sintagmën ndajfoljore. Kur flet për sintagmën foljore (SF), autori përcakton se kjo e fundit mund të ndiqet dhe nga një fjali F, por pa e emërtuar si sintagmë. Si specifikues të foljes sheh një SE, që tradicionalisht është kryefjala e fjalisë, ndërsa si nyje dominuese në projeksionet maksimale shfaqen folje ndihmëse, mbaresa, ndajfolje. Ndajfoljet nuk formojnë sintagma, sipas tij, pasi ato nuk janë elemente të domosdoshme për fjalinë bazë dhe janë të përsëritshme¹⁵.

Gjithashtu në studimet gjenerative për shqipen përdoret dhe koncepti i kokave funksionale të tilla si sintagmat fleksionale SF (IP), sintagmat e përshtatjes SP (AgrP) dhe të kohës SK (TP¹⁶) të cilat e zgjeruan jashtëzakonisht konceptin e sintagmës. Ato gjithashtu përfshinë në vetvete konfigurimin e elementeve të tilla, që tradicionalisht ishin studiuar në rrafsh morfologjik, tashmë dhe në aspektin strukturor të realizimit të tyre në strukturë të thellë e më pas, duke shpjeguar elemente të veçanta të shqipes në strukturë sipërfaqësore.

Po në kuadrin e sintagmës është parë dhe një pjesë e fjalive të nënrenditura. Ludmila Buxheli në një nga punimet e saj në lidhje me caktimin rasor të rasës emërore¹⁷, fjalinë e pavarur e sheh në kuadrin e sintagmës eptimore, ndërsa fjalinë e varur e sheh si sintagmë lidhëzore SL, apo komplementuese. Në këtë kontekst teoria e sintagmës e zgjeroi mjaft shtrirjen e saj, duke vënë në skemat e saj dhe njësi të tilla tradicionale si fjalitë e nënrenditura. (Sintagma funksionale e komplementuesit CP që përfshin koka specifike si lidhëzat *se*, *që*, *nëse* etj., e konsolidon edhe fjalinë e varur si sintagmë, ndonëse në diagramet përkatëse është në kuadrin e sintagmës flektive¹⁸).

¹⁵ J. Mita, *Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe*, Studime albanologjike, Tiranë, 2000, f. 35.

¹⁶ F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, shblu, Tiranë, 2011, f. 44-46.

¹⁷ L. Buxheli, *Rreth caktimit rasor të rasës emërore në shqipen e sotme*, SF, 2005/3-4, f. 75.

¹⁸ F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, shblu, Tiranë, 2011, f. 49.

Koncepti i sintagmave determinante (DP), kuantifikatore (QP) etj., detajon më hollësisht strukturën e brendshme të sintagmave sidomos asaj emërore SN. Në këto studime hasim dhe nocionin e sintagmës bashkërenditëse (CoordP¹⁹), që sipas nesh, përbën dhe një shtrirje të konceptit dhe brenda studimeve gjenerative, pavarësisht se nuk jepen të gjitha strukturat me të cilat del në rrafsh sipërfaqësor, por vetëm prezantohet më shumë si e tillë.

Pra shihet se gjenerativizmi solli një konceptim tërësisht të ri dhe origjinal të studimeve në fushë të shqipes në lidhje me sintagmën. Kufijtë e vëllimit të tij u zgjeruan dhe nga ana sasiore, por sidomos nga ajo cilësore. Sintagma mori një rol qendror në shpalosjen e marrëdhënieve të brendshme të fjalisë tradicionale. Veç kësaj, mënyra e konfigurimit të elementeve të saj përbërëse, pasqyrore më qartë dhe më saktë këto marrëdhënie dhe projektionet e tyre specifike, duke paraqitur dhe hierarkitë e krijuara. Elementi minimal i sintagmave mund të jetë dhe një njësi e vetme, përkatësisht koka. Ashtu siç u përmend, u rrit numri i kategorive që mund të formonin sintagma. Kështu parafjala dhe lidhëzat mund të ishin koka gjithashtu. Struktura e brendshme e sintagmës u pasqyrua më qartë me dallimin mes specifikesit dhe argumentit. Skemat që janë paraqitur në lidhje me sintagmat e strukturës së shqipes dhanë dhe një ide më të qartë të lidhjeve dhe hierarkive të krijuara si në strukturën e një sintagme, por dhe mes sintagmave të ndryshme. Në këtë mënyrë trajtimi gjenerativ bën përshkrim të hollësishëm të njëjësive përbërëse duke gërshetuar në këtë analizë disa rrafshet studimi. Në këtë kontekst sintagma nuk shihet më si një njësi thjesht ndërtuese, por merr rol mjaft të rëndësishëm në perspektivën e përshkrimit të strukturës së shqipes. Gjithsesi duhet thënë se këto trajtime nuk janë reflektuar në tekstet parauniversitare direkt. Nëse vëmë re ndonjë shenjë, mendojmë se ajo është ndikim i gramatikave të gjuhëve të tjera, të cilat janë shqyrtuar gjatë hartimit të këtyre teksteve.

Lidhur me teorinë e sintagmës dhe zbatimin e saj në gjuhën shqipe të tërheq vëmendjen dhe një këndvështrim ndryshe i analizës së pjesëve të sintagmës, nga Lindita Rugova. Duke iu referuar librit të R. Memushajt, por ndryshe nga ky autor, Rugova fjalinë e varur nuk e shikon në kuadrin e sintagmës, megjithëse pranon që ajo është në vendin e një paspërcaktori. Sipas Rugovës, “Fjalitë e varura ...mund të jenë pjesë e një sintagme, d.m.th. në më të shumtën e rasteve mund kenë funksionin e një paspërcaktori të kokës apo fjalës bosht të sintagmës emërore, por nuk mund të jenë sintagma.”²⁰

Së pari, fjalia filluese, e marrë si element i kritikës së studiueses së mësipërme, nuk varet vetëm nga një kokë emërore, por përkundrazi shumë

¹⁹ F. Koleci, G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, shblu, Tiranë, 2011, f. 166-174.

²⁰ L. Rugova, *Sintagmat sintaksore të gjuhës shqipe*, “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, 25/1, Prishtinë, 2006, f. 422.

shpesh shfaqet e varur nga koka foljore: (“E gëzonte mendimi se do ta takonte.” - është fjalia marrë si shembull nga libri i Memushajt, por strukturat kryesore dalin me folje në formë joveprore ose veprorë: Dihet se ata do të vijnë. / Mendohej se ne do të merrnim Statusin Kandidat. etj.). Për këtë arsye mendojmë se, sidomos pozicioni i fundit favorizon faktin që dhe fjali të tilla mund të jenë komplemente.

Së dyti, koncepti i sintagmave komplementuese i studimeve gjenerative²¹ (meqenëse ajo nisët pikërisht nga ky drejtim, siç del nga një pjesë referencash), e hedh poshtë argumentin e shprehur prej saj, duke iu dhënë të drejtën dhe fjalive të nënrenditura të shihen si sintagma.

Pavarësisht se Rugova nuk mbështetet në një teori të vetme, sipas nesh, madje shpesh u referohet herë strukturalistëve amerikanë paragjenerativistë e gjenerativistë (Blumfeld, Harris, Çomski etj.²²), e herë atyre me prirje deskriptiviste (Bucholcit dhe Fidlerit, madje dhe autorëve të Gramatikës së Kembrixhit, të botuar në vitin 2002, Pollum dhe Hadëllstoun, të cilët pavarësisht punimeve që mund të kenë pasur dhe në lëmin gjenerativ, këtu theksojnë faktin se kanë të bëjnë më një gramatikë deskriptive.²³), ajo që mendojmë se vlen në këtë punim është dallimi në mikrostrukturë mes elementëve të tillë, të cilët ajo i emërton si parapërcaktorin/paspërcaktorin dhe caktuesorin, për të cilët jepet ky karakterizim: “Sintagmat përbëhen nga koka dhe nga elementet e varura të saj. Varësia është term i gjërë në këtë aspekt dhe duhen dalluar dy nëntipe të varësisë në këtë rrafsh: parapërcaktonin (angl. *premodifier*), i cili i prin kokës së sintagmës, dhe paspërcaktorin (angl. *postmodifier*), i ndjek ose pason kokën e sintagmës. Meqë sintagmat emërore janë më të llojllojshmet dhe më komplekset në këtë kuadër, po të njëjtat mund të zbërthehen dhe një element tjetër të varësisë, më të ulët se ai i përcaktorëve, në caktuesorë falë natyrës shumë flektive të gjuhës.” (Rugova:423).

Nga trajtimi i mësipërm mendojmë se, së pari, përcaktimi i Rugovës mbi marrëdhëniet e varësisë nuk është i qartë se cilës teori i përket. Së dyti, elementi kryesor i varësisë, sipas saj, është përcaktori me dy shfaqjet e tij, (para/paspërcaktorin). Përcaktimi për këtë të fundit mendojmë se është i pjesshëm, pasi është thjesht strukturor dhe nuk parashikon vëllimin dhe llojet e ndryshme të shfaqjeve të tij, në varësi të kokave të ndryshme. Për karakterizim semantik nuk flitet. Në lidhje me caktuesorin, mund të themi se ai u referohet përgjithësisht elementeve flektive vetëm të emrit dhe jo të kokave të tjera

²¹ L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, 2007.

²² L. Rugova po aty, f. 421.

²³ G. Pollum; R. Huddleston, *The Cambridge Grammar of the English Language*, 2002, përkatësisht në kapakun mbështjellës të Gramatikës, autorët vënë në dukje faktin se këtu kanë të bëjnë më një punim deskriptiv.

leksikore (duke përfshirë dhe nyjen *një* të pashquarsisë), kur dihet se fleksion ka dhe folja, përemri dhe mbiemri.

Megjithatë, pavarësisht vërejtjeve tona në lidhje me këtë këndvështrim të ri të analizës së pjesëve të sintagmës, pajtohemi me mendimin e autores se është emergjente përcaktimi i një qëndrimi të njëjtë në lidhje me këtë dukuri, i cili duhet të reflektohet në tekstet parauniversitare, për të shmangur atë rrëmujë që vihet re në to.

Në parashtrimin e mësipërm u munduam të japim një historik të trajtimit të konceptit të togfjalëshit dhe sintagmës në studimet tona, duke marrë shtysën nga punimi i Floqit. Më pas paraqitëm një pjesë të mirë të studimeve dhe autorëve që u morën me teorinë e sintagmës pas viteve 90-të (në këndvështrimin gjenerativist), si teoria që zëvendësoi atë të togfjalëshit në studimet tona. Përkrah secilit konceptim kemi dhënë dhe argumente në lidhje me anët e mira dhe ato të dobëta, që ne gjykojmë se kanë paraqitur konceptimet e mësipërme.

Ajo që duam të shtojmë është se në lidhje me sintagmën nuk ekziston vetëm qasja gjenerative, por dhe këndvështrime të tjera (një ndër të cilët është dhe i deskriptivist i teorisë së valencave). Ne mendojmë se studimet tona teorike dhe praktike e kanë të nevojshme shtrirjen e këndvështrimit edhe te këto teori të tjera, për të pasur një një përshkrim sa më të mirë të strukturës sintaksore, morfologjike dhe semantike të grupeve të fjalëve, të cilat tashmë nuk shihen thjesht si elemente ndërtuese, por si njësi organizuese, qeverisëse, të cilat mund të përfaqësojnë dhe njësinë kryesore të gramatikës tradicionale siç është fjalia. (Herbst²⁴ vëren se këtë konceptim nuk e ka vetëm ai, po e gjen dhe te Quirk, Greenbaun²⁵..., apo dhe te Pollum dhe Huddleston²⁶). Gjithashtu, kërkohet një gërshetim më i mirë i rrafshit semantik e sintaksor. Kjo e fundit do të jepte mundësinë e pasqyrit të gjithë modeleve të mundshme të projeksioneve të kategorive të ndryshme, duke përfshirë dhe shfaqjet idiomatike.

Ballafaqimi i teorive të ndryshme dhe përzgjedhja e kodifikimi i një varianti më të përshtatshëm për shqipen në lidhje me përcaktimin sa më të plotë të të gjitha modeleve, në të cilat projektohen kokat e ndryshme të sintagmave, do të ndihmonte dhe në përcaktimin e një metodologjie, e cila do

²⁴ H. Herbst, S. Schüller, *Introduction to Syntactic Analysis. A Valency Approach*, Tübingen, 2008.

²⁵ Quirk, Greenboun, Svartnik et al, *Contemporary Grammar of English Language*, London, New York, Longman, 1985.

²⁶ G. Pollum, R. Huddleston, *The Cambridge Grammar of the English Language*, 2002.

të bënte të mundur identifikimin dhe magazinimin e këtyre të fundit në korpuse strukturore të grupuara në banka gjuhësore siç i kanë kodet e tjera²⁷.

Së fundi, siç kanë theksuar dhe autorë të tjerë, dalja me një qëndrim të studiuar mirë dhe të përbashkët, jo vetëm në rrafsh teorik, por dhe praktik në lidhje me sintagmën, sot përbën një domosdoshmëri, pasi do të shmangte diletantizmin dhe atë çoroditje të madhe që vihet re në tekstet parauniversitare.

BIBLIOGRAFI

- A. Kananaj, *Rrethanori në këndvështrimin gjenerativ*, Punim për gradën Master, Tiranë, 2006.
- D. Kallulli, Clitics in Albanian. *Working Papers in Linguistics* 24. University of Trondheim, 1995.
- E. Kapia, *Acquisition of English Reflexives by L1 Albanian Speakers: Features of Inter-Language Grammar*, "Theoretical And Empirical Studies In Albanian Syntax", Lincom Europa, 2012.
- F. Koleci & G. Turano, *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shblu, Tiranë, 2011.
- Fjalori i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980.
- G. Pollum, R. Huddleston, *The Cambridge Grammar of the English Language*, 2002.
- Gramatika I, II*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 2002.
- H. Agani, *Ç'shoh të diskutueshme në çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, Revista "Fjala", 1 shkurt, 15 shkurt, 15 mars, Prishtinë, 1975.
- H. Herbst, S. Schüller, *Introduction to Syntactic Analysis. A Valency Approach*, Tübingen, 2008
- J. Lukaj, *Togfjalëshi*, Buletin shkencor, Shkodër, 1972, nr. 2.
- J. Mita, *Struktura e sintagmave në gjuhën shqipe*, Studime albanologjike, Tiranë, 2000.
- J. Mita. *Hyrje në sintaksën gjenerative*, Prishtinë, 2005.
- K. Tarvainen, *Semantic cases in Framework of Dependency Theory*, Concept of case, Gunter Narr Verlag Tübingen, 1985.
- L. Buxheli, *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, 2007.
- L. Buxheli, *Rreth caktimit të rasës emërore në shqipen e sotme*, SF, 2005/3-4.
- L. Haegeman, *Introduction on the government and binding theory*, Oxford, 1991.

²⁷ Kemi parasysh *The Bank of English*, apo Fjalorët e Valencave që janë përgatitur për gjuhë të ndryshme, FrameNet-in e Fillmorit, modelet që paraqet Beth Levin etj.

- L. Rugova, *Sintagmat sintaksore të shqipes*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2006.
- L. Tesnière, *Elements de Syntaxe Structurale*, Paris, 1959.
- Quirk, Greenboun, Svartnik et al, *Contemporary Grammar of English Language*, London, New York, Longman, 1985.
- R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, shblu, Tiranë, 2008, f.109.
- R. Përnaska, *Diskutim për kumtesën e Spiro Floqit*, “Revista pedagogjike”, 1972, nr. 5.
- S. Floqi, *Çështje të teorisë së togfjalëshit në shqipen e sotme*, SF, 1968/1.
- S. Levinson, *Pragmatics*, Cambridge University Press, 1992.
- Th. Dhima, *Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe (përmbledhje artikujsh)*, Tiranë, 2013, 278 faqe.

SUMMARY

PHRASE, SYNTAGMA AND THEIR TREATMENTS IN ALBANIAN GRAMMATOLOGY

In this paper we have described the history of the Albanian linguistic term “togfjalësh” (group of words) in our linguistics studies since 1968 when the Albanian linguist Spiro Floqi represented through his theory, and the notion of sintagma (phrase in English studies) used after 90-ies from different linguists. We have confirmed that the concept of Floqi has been the main theory that was taken into consideration from our grammar (Grammar II, published by Science Academy of Albania, 2002). The concept of Predicative Phrase hasn't been accepted in this Grammar. The influence of the French structuralist L. Tesnière is reflected through his theory, despite the political constraints of his époque. However his work didn't have real at least syntactic criteria's. The microstructure of “togfjalësh” and the relationships among the elements that are parts of this group of words are not very clear, beside the number of heads was limited. Predicative group was also a reflection of the influence of European structuralism in Floqi's work. At the end he considers togfjalësh as a constructing element between word and sentence. So he neglected the main role that coherent theories have offered to these word classes, not only in constructing of the traditional sentence, but even in their specific syntactic projection in relation with morphologic and semantic aspect.

After 90-ies in the Albanian linguistics the notion “togfjalësh” (group of words) has been criticized and instead of it it was used the theory of sintagma (phrase). Many authors have given the formal generative

configurations about generally four types of phrases at first (NP-noun phrase, VP-verb phrase, PP-prepositional phrase and AP-adjective phrase, someone even for adverb phrase), and then about functional phrases like Agreement Phrase, Inflectional Phrase etc.

Eventhough this point of view helped to describe the structure of albanian phrases in details, we have noted that this theory remained a formal one that usually represents some formal stereotypes of structures, mostly taken from Deep Structure, neglecting often Surface Structure with many patterns (frames) that cannot be explained from the universal schemas given by them. Semantic component was not taken in consideration too, however in the second period of the development of this point of view they tried to implicate this notion (semantic filters) etc.

We think that other theories should be consulted in order to find the appropriate one for the structure of Albanian language. After this, these studies should be codified even in texts used by the students of elementary and high schools.

